



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 4718 Prot.

Lezhë, më 19.03.2021

VENDIM

Nr. 47 Datë 17.03.2021

**“PËR PËRDORIMIN E FONDIT SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR PËR
NDIHMËN EKONOMIKE ME FONDE TE BUXHETIT VENDOR PËR VITIN 2021”**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015“Për Vetëqeverisjen Vendore” si dhe në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr . 597 datë 4.9.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, nisur nga situata e zgjatur e pandemisë dhe e pasojave ekonomike dhe sociale që po kalojmë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

VENDOSI:

1. Të miratohen kriteret e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike **me fonde të buxhetit vendor**, si më poshtë:
 - a. Familjet në nevojë do të përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar brenda tre muajve të fundit nëpërmjet Regjistrimit Elektronik Kombëtar për ndihmën ekonomike dhe që nuk janë shpallur përfitues nga sistemi i pikëzimit me arsyen: Nuk ka marrë pikët e mjaftueshme.
 - b. Për të gjitha familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike sipas këtij fondi, duhet të jetë kryer paraprakisht vlerësimi social - ekonomik në familje nga administratori shoqëror sipas shtojcës 2 të VKM nr.597 datë 4.9.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.
 - c. Masa e ndihmës ekonomike për familjet përfituese nga ky fond llogaritet në të njëjtën mënyrë sipas përlllogaritjes së masës së strukturës së familjes, për familjet përfituese të ndihmës ekonomike.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
ERNEST RAKAJ

